

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-120/2014  
GSK-KPA-A-126/2014**

Prishtinë, 14 korrik 2016

Në çështjen juridike të:  
Në lëndën GSK-KPA-A-120/2014:

Subjekti juridik **U. K. DOO**

***Pala ankuese***

Përfaqësuesi: A. Q. V.

Avokat në Prishtinë

kundër

K. P.

Prishtinë

***Palë përgjegjëse në kërkesë para AKP/KKPK-së, nuk i është bashkangjitur procedurës në ankesë***

Dhe në lëndën GSK-KPA-A-126/2014:

**K. e H. të E.**

***Pala ankuese***

Përfaqësuesi: B. L.,

Kundër

Subjektit juridik **U. K.DOO**

Përfaqësuar nga drejtori i saj M. R.

***Pala përgjegjëse në ankesë***

Dhe kundër

K. P.  
Prishtinë

***Palë përgjegjëse në kërkesë para AKP/KKPK-së, nuk i është bashkangjitur procedurës në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Krassimir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) nr. KPCC/D/C/216/2013, të datës 21 gusht 2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) me numrin KPA14320), në tekstin e mëtejme gjithashtu: vendimi i KKPK-së, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 14 korrik 2016, mori këtë:

### **AKTGJYKIM**

- 1. Hidhet poshtë si e paafatshme ankesa e U. K.DOO kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/C/216/2013, e datës 21 gusht 2013, për sa i përket kërkesës nr. KPA14320.**
- 2. Hidhet poshtë si e papranueshme ankesa e K. së H. të E. kundër vendimit të KKPK-së nr. KPCC/D/C/216/2014, të datës 21 gusht 2013, për sa i përket kërkesës nr. KPA14320 sepse Komuna nuk ka interes ligjor në ankesë.**

### **Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike**

1. Më 10 tetor 2006 M. R. si përfaqësues i autorizuar i subjektit juridik U. K. DOO (në tekstin e mëtejme: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon vërtetimin e të drejtave të tij të shfrytëzimit, ri-posedim si dhe kompensim për shfrytëzimin e jashtëligjshëm të objekteve magazinuese ushtarake me numrat 2 dhe 22 me sipërfaqe të përgjithshme prej 481 m<sup>2</sup> në vendkalimin kufitar H. i E. (në tekstin e mëtejme: pronat e kërkuara). Ai pretendon të jetë qiradhënës i përhershëm i pronave të kërkuara dhe ka

theksuar se ka humbur pronat e kërkuara më 12 qershor 1999 si rezultat i rrethanave gjatë viteve 1998/1999 në Kosovë.

2. Paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar *inter alia* në AKP:

- Një vendim të Gjykatës Ekonomike të Prishtinës, të datës 15 maj 1997, nr. FI-403/97, lidhur me regjistrimin e paraqitësit të kërkesës;
  - Një vendim të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Republikës së Serbisë, të datës 4 gusht 2005, nr. 87619/2005; sipas këtij vendimi M. R. është i regjistruar si drejtor dhe përfaqësues i paraqitësit të kërkesës;
  - Një vendim të Kuvendit Komunal të Kaçanikut, Drejtorati për Urbanizëm, Çështje Banesore, Komunale dhe Juridiko-Pronësore, me nr. 351-51/95, të datës 26 prill 1995; sipas këtij vendimi paraqitësi i kërkesës ishte lejuar të shfrytëzonte përkohësisht pronat e kërkuara; leja është e vlefshme deri në datën e skadimit të kontratave të qiradhënies, shkurt 1995, për pronat të kërkuara të lidhura ne mes të postës ushtarake dhe paraqitësit të kërkesës.
3. AKP ka bërë njoftimin e kërkesës më 6 shkurt 2009 duke e vendosur një njoftim lidhur me kërkesën në adresën Objekti Caringskog 2 dhe 22 në Han të Elezit, më herët i njohur si Đeneral Janković, koordinata veriore 1 0524375/ koordinata veriore 2” 4666546. Gjatë kryerjes së njoftimit AKP-ja gjeti se pronat e kërkuara janë objekte komerciale dhe të zëna nga Kosova Petrol.
4. K. P. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në kërkesë) ka paraqitur përgjigje në kërkesë.
5. KKPK me vendimin KPCC/D/C/216/2013, të datës 21 gusht 2013, e ka refuzuar kërkesën me arsyetimin (në paragrafin 37) se paraqitësi i kërkesës nuk ka dorëzuar prova për të dëshmuar të drejtat e tij të pretenduara pronësore në pronat e kërkuara. Në faqen e fundit vendimi i KKPK-së përmban informacione lidhur me mundësinë për të paraqitur ankesë brenda 30 ditëve nga njoftimi lidhur me vendimin.
6. Vendimi i KKPK-së së bashku me fletën për njoftimin mbi ankesën, i ishte dorëzuar përfaqësuesit të autorizuar të paraqitësit të kërkesës, M. R., më 20 dhjetor 2013 ndërsa palës përgjegjëse në kërkesë më 18 dhjetor 2013.
7. Më 31 janar 2014 paraqitësi i kërkesës ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Kjo ankesë është e regjistruar në Gjykatën Supreme me numrin GSK-KPA-A-120/2014. Me ankesë ai

- ka dorëzuar një autorizim. Ky autorizim e autorizon avokatin A. Q. V. që të përfaqësoj paraqitësin e kërkesës në ankesë.
8. Më 4 prill 2014 K. e H. të E. (në tekstin e mëtejme: Komuna) gjithashtu ka paraqitur ankesë kundër vendimit të njëjtë të KKPK-së. Kjo ankesë është e regjistruar në Gjykatën Supreme me numrin GSK-KPA-A-126/2014.
  9. Në përgjigje të urdhrin të gjykatës të datës 28 prill 2016, Komuna ka dorëzuar një vendim të Kryetarit të Komunës të datës 14 shkurt 2014, 02.No.1084/2014, për të paraqitur ‘ankesa lidhur me pronat e ish armatës’ në gjykatën kompetente ‘lidhur me ngastrat në vendimin e KKPK-së të shënuara në Certifikatat mbi të drejtat e pronës së paluajtshme si ngastrat kadastrale 16-0, 17/1 dhe 20-0’, si dhe autorizimin e datës 16 maj 2016 ku autorizohet B. L., Shef i Zyrës Ligjore dhe Përfaqësues Ligjor i Komunës, që të përfaqësoj Komunën në lëndën 126/2014.

### **Pretendimet e palëve ankuese**

10. Paraqitësi i kërkesës kundërshton vendimin e KKPK-së për shkak se përmban gabim thelbësor dhe shkelje të rëndë të së drejtës procedurale dhe se mbështetet mbi vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, ai ka kërkuar nga Gjykata Supreme të miratoj ankesën e tij dhe të anuloj vendimin e KKPK-së si të pabazuar dhe të jashtëligjshëm. Paraqitësi i kërkesës thekson se ai është pronar i padiskutueshëm i pronave të kërkuara.
11. Komuna në ankesën e saj thekson se pronat e kërkuara gjenden në ngastrën kadastrale nr. 16. Kjo ngastër i ishte dorëzuar Komunës nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës më 16 janar 2009. Komuna kërkon që të prishet vendimi i KKPK-së dhe të refuzohet kërkesa si e pabazuar.

### **Arsyetimi ligjor**

*Pranueshmëria e ankesës së paraqitësit të kërkesës në lëndën nr. 120/2014*

12. Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) parasheh me sa vijon: “*brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin [e KKPK-së] mbi kërkesën, pala mund të dorëzoj përmes Sekretarisë*

*Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatën Supreme të Kosovës një ankesë kundër një vendimi të tillë”.*

13. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 20 dhjetor 2013 dhe paraqitësi i kërkesës duhet të dorëzojë ankesën brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me dispozitën e lartpërmendur. Paraqitësi i kërkesës e ka paraqitur ankesën të premtën më 31 janar 2014. Kjo datë është dita e 42-të pas njoftimit lidhur me vendimin e KKPK-së dhe kështu bie jashtë afatit të paraparë me ligj.
14. Paraqitësi i kërkesës nuk ka dhënë asnjë shkas justifikues për paraqitjen e ankesës pas kalimit të afatit.
15. Ai ishte paralajmëruar mjaftueshëm lidhur me afatin, pasi që vendimi përmbante një paralajmërim për këtë afat.
16. Prandaj, ankesa e paraqitësit të kërkesës në lëndën me numrin 120/2014 duhet të hidhet poshtë si e paafatshme në përputhje me nenin 13.3 nën-paragrafi (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 195.1 (a) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

*Pranueshmëria e ankesës së Komunës në lëndën nr. 126/2014*

17. Komuna në ankesën e saj kërkon që të refuzohet kërkesa nr. KPA14320 e paraqitësit të kërkesës dorëzuar në AKP/KKPK-së.
18. Në vendimin e kundërshtuar KKPK tanimë kishte refuzuar kërkesën. Pasi që ankesa e paraqitësit të kërkesës në lëndën 120/2014 është hedhur poshtë, vendimi i KKPK-së është bërë i plotfuqishëm.
19. Në këto rrethana Komuna nuk ka interes ligjor që të paraqes ankesë sepse me ankesë Komuna nuk mund të përfitoj një pozitë më të mirë për sa i përket kërkesës KPA14320. Prandaj, pasi që Komuna nuk ka interes ligjor, ankesa duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 186.3 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore që është i aplikueshëm në këtë procedurë për shkak të nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

*Konkluzion*

20. Prandaj, në përputhje me nenin 13.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, Gjykata Supreme vendos në të dyja lëndët si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë juridike**

21. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit**

**Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Nënshkruar nga: Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it**